




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 422/Prot

01.09.2022



Shkodër më 01.09.2022

Nr. 100/1 prot.

Lënda: Mbi Vendimin nr. 1, datë 26.01.2022 të Këshillit të Bashkisë Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja “n”, neni 55, pika 2, neni 64, shkronja “c”, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, kreu IV, pika 1, të Udhëzimit të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 5, dt. 17.02.2017 “Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6 për qind”, i ndryshuar, të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 “Për miratimin e rregullores së brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I, “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, shqyrtoi VKB Vau Dejës nr. 1, datë 26.01.2021 “Mbi kriteret për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike duke përdorur deri në 6% të fondit të ndihmës ekonomike”.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni, por me korrigjimet tek baza ligjore si më poshtë:

Ligji nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar, është shfuqizuar nga ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”

VKM nr. 955, datë 07.12.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, dokumentacionit dhe masës së ndihmës ekonomike”, të ndryshuar, është shfuqizuar nga VKM nr. 597, dt. 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

Ju sjellim në vëmendje që pika 5 përfshin të shtuar katëgorinë e “të rinjve me probleme social ekonomike”, kategori kjo e pa parashikuar në legjislacion.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA VAU DEJËS
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr 01 . Date 26 / 01 /2022

Mbi Kriteret per dhënien e e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri 6% per vitin 2022

Bazuar ne nenin 21 te ligjit nr.9355,date 10.03.2005"Per ndihmen dhe sherbimet shoqerore "(ndryshuar),bazuar ne VKM nr.955 date 07.12.2016"Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhimes Ekonomike"si dhe bazuar ne Udhezimin Nr,5 date 17.02.2017,"Mbi perdorimin e fondit te kushtezuar per bllok-ndihmen ekonomike deri ne 6%"

KESHILLI BASHKIAK :

VENDOSI


Te miratohen Kriteret Specifike per vitin 2022 mbi te cilat do te bazohet Vendimi i Keshillit Bashkiak per te trajtuar me ndihme ekonomike duke perdorur deri ne 6% te fondit te kushtezuar per bllok ndihmen ekonomike,familjet te cilat nuk shpallen fitues sipas formule se pikezimit.

- 1-Familje te varfera pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme,qe nuk plotesojne nevojat baze per jetese.
- 2-Familje qe kane ne perberje nje ose me shume anetare me aftesi te kufizuar/invalid pune.
- 3-Familje me shume femije
- 4-Familje me k/familjare femra pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme,dhe me problem sociale.
- 5-Persona qe jetojne te vetem ,te moshuar, te rinj me probleme social ekonomike.
- 6-Familje me te ardhura te pamjaftueshme qe ka ne perberje femije qe ndjekin arsimin e larte.
- 7-Familjet qe nuk kane banese ose jetojne me qera.
- 8-Familje qe kane ne perberje te moshuar,qe nuk kane pension ose e kane pension minimal.
- 9-Kryefamiljare gra te veja apo te divorcuara pa te ardhura apo me te ardhura te pamjaftueshme.

I-Dokumentat e aplikuesve jane sipas VKM nr.955 date 07.12.2016"Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhimes Ekonomike".

II-Masa e ndihmes ekonomike llogaritet siopas VKM nr.955 date 07.12.2016"Per percaktimin e kriterëve ,Dokumentacionit dhe Mases se Ndhimes Ekonomike".dhe Udhezimit nr 4 date 17.02.2017"Per perllogaritjen e perfitimit te ndihmes ekonomike"

Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Sektori i Ndhmës Ekonomike.



SEKRETARI I KESHILLIT
Ardian CELEPIJA



KRYETARI I KESHILLIT
MARK BISHA

Miratuar me 19.....vota

Vota pro 19.

Vota kunder -.....

Vota Abstenim -.....

Zbardhur me date 31.01.2022